



NGJALLJA

Nr. 10 (225) Viti XIX i botimit

TETOR 2011

Çmimi 20 lekë

Orthodhoksët e Shqipërisë, kujtojnë gjithnjë me ndjenja mirënjohjeje, iniciativën historike të Tërëshenjtërisë së Tij, Patriarkut Ekumenik. z. Vartholomeu, në vitet 1991-92, për ringritjen e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, si dhe për mbështetjen e tij të vazhdueshme në përpjekjet e reformimit të saj.

Me rastin e përvjetorit të njëzetë të fronëzimit të tij në Fronin Ekumenik,



Në foto: Në vitin 1999 Patriarku Ekumenik, Tërëshenjtëria e Tij Vartholomeu I, bëri vizitën e tij të parë zyrtare në Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Çast nga Liturgjia Hyjnore në Kishën "Ungjillëzimi i Hyjlindëses", në Tiranë.

lutemi që fryma e Shpirtit të Shenjtë të drejtojë vazhdimisht mendimet dhe vendimet e tij dhe të fuqizojë pareshtur veprimet dhe përpjekjet e tij për

unitetin dhe zhvillimin e Kishave Orthodhokse dhe rrezatimin e Orthodhoksisë në botën bashkëkohore.

U kremtua 20-vjetori i zgjedhjes Patriark Ekumenik i Tërëshenjtërisë së Tij, Vartholomeut I

Me rastin e 20-vjetorit të zgjedhjes së Patriarkut Ekumenik, Tërëshenjtërisë së Tij, Vartholomeut I në fronin Ekumenik të Kostandinopojës, ditën e shtunë, 22 tetor, u organizuan disa veprimtari të ndryshme në Kishën patriarkale të Shën Gjergjit, ku u përcollën dhe përshëndetjet e rastit nga përfaqësitë e Kishave Orthodhokse në botë. Urimet për primatin e Kishës mëmë ishin të shumta dhe shpresëdhënëse.

Urimet nga ana e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë ia shprehu Kryepiskopi Anastas, i cili shoqërohej edhe nga Arkimandrit Asti Bakallbashi. Patriarku Ekumenik është dalluar gjatë gjithë këtyre 20 vjetëve për dashurinë e ngrohtë dhe mbështetjen e pandërprerë që i ka dhënë Kishës sonë në ringritjen e saj nga gërmadhat.



Në foto: Çast nga celebrimi i këtij 20-vjetori në Kryekishën patriarkale të Shën Gjergjit, në Konstandinopojë.

Ditën e diel, 23 tetor, u krye Liturgjia Hyjnore e rastit. Në Kishën patriarkale të Shën Gjergjit bashkëmehuan Patriarkët Vartholome dhe ai Irine i Sërbisë, në vizitën e Tij të parë zyrtare pas zgjedhjes.

Patriarku Ekumenik, Vartholomeu I dhe dialogët ndërfaqësorë

Nga Kryepiskopi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë,

Prof. Dr. † Anastasi

(Lexoni në faqen 7)